



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1285/Prot.
2

Tiranë, më 30/10/2020

V E N D I M

Nr.14, datë 30.10.2020

"PËR
MBARIMIN E MANDATIT TË ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË
PERSONELIT AKADEMIK"

Mbështetur në ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 1, gërma i, si dhe Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Senati i Akademik në mbledhjen e tij të datës 30.10.2020,

V E N D O S I:

1. Të përcaktojë rastet e mbarimit të mandatit të anëtarëve në Komisionin e Promovimit të Personelit Akademik (KPPA) në Universitetin Politeknik të Tiranës.
2. Mandati i anëtarëve të KPPA mbaron kur:
 - a. Përbushet afati dy-vjeçar i mandatit;
 - b. Jep dorëheqjen;
 - c. Largohet nga UPT;
 - d. Bëhet i pamundur nga ana fizike apo mendore të ushtrrojë funksionin;
 - e. Dënohet me vendim të formës së prerë;
 - f. Ka kryer shkelje të rënda të ligjit dhe Kodit të Etikës së UPT – së;
 - g. Mbush moshën për pension pleqërie.
3. Në rastet kur një vend në KPPA mbetet vakant, ai plotësohet nga kandidati pasardhës në renditje për nga numri i votave. Në këtë rast mandati i anëtarit të ri është plotësues.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,
Tel/Fax: +355 4 2227914,
web: www.upt.al